



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 254, datë 15.06.2021**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË**  
**VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË**  
**FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku dhe Olti Skrame, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje me armë”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 140 dhe 25 i Kodit Penal”.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë; Objekti: “Kërkesë pushim çështje”.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shefkije Mataj dhe Arben Micko, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin; Objekti: “Gjykimin e çështjes penale në ngarkim të {...}, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Besmir Stroka dhe Hasan Selimi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; Objekti: “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr.75 viti 2020 në ngarkim të pandehurit, {...}akuzuar për veprën penale “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë të parashikuar nga neni 76-22 i Kodit Penal”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TROPOJË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Florin Demollari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë; Objekti: “Gjykimin e procedimit penal me nr.91 të vitit 2020, në ngarkim të të pandehurit {...} i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vjedhje”, në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Alma Ahmeti, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë; Objekti: “Gjykimin e procedimit penal me nr.66/1 të vitit 2021, në ngarkim të të pandehurës {...} e akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Kultivim i bimëve narkotike”, e parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Flutura Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen civile me Paditës: {...}; Palë e paditur (i pandehuri): {...}; Objekti: “Detyrimin e të paditurit {...} (i pandehuri) për të dëmshpërblyer trashëgimtarët e viktimës së veprës penale për dëmin pasuror e jopasuror të pësuar si rezultat i vrasjes së babit të paditësit nga i padituri-i pandehur”.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Miranda Nakaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...} etj; Akuza: Neni 324/a/1 i Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Saemira Hila, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 283/1 i Kodit Penal.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Arjeta Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 83 i Kodit Penal.

### **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Klejda Çapja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje me dashje”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 76, 25 e 22 i Kodit Penal”

### **GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË DURRËS**

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gentian Hamiti, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, çështjen civile me Paditës: {...}, etj.; Të paditur: {...}, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, {...}, etj.; Objekti: “Detyrim për shitje trualli nën objekt dhe pjesë funksionale të saj, për objekte në pronësi të paditësit. Konstatim i pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes së truallit me nr.572 Rep. Nr.342 kol, datë 19.03.1998 lidhur midis Degës së AKP{...}e të paditurit {...}, etj.”.

### **GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Adrian Shega, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: Shoqëria Tregtare {...}sh.p.k; Të paditur: {...}, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, etj.; Objekti: “Detyrimin e ndërgjyqsave të paditur {...}, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, solidarisht, për të dëmshpërblyer paditësin Shoqëria {...} për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar atij, për shkak të mosmarrjes së masave nga i padituri {...} për ndërprerjen e gjendjes së paligjshmërisë (diskriminimit të paditësit Shoqëria “{...} sh.p.k në çështjen gjyqësore të mësipërme, etj.”

### **GJYKATA E APELIT DURRËS**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen civile me Paditës{...}; Të paditur: {...}, {...}, shoqëria “{...} etj.; Objekt: “Njohje e pavërtetësisë së dokumentit kontratë shitje datë 15.04.2017 midis shitësit {...} dhe blerësit {...} . –Njohje e pavërtetësisë së dokumentit vendim i Asamblesë së shoqërisë “{...}” sh.p.k., datë 15.04.2017, etj.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Fuat Vjerdha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 89 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Astrit Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur {...} ; Akuza: “Nenet 143/2 dhe 145 të Kodit Penal”.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal”.

### **GJYKATA E APELIT KORÇË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me Të pandehur {...}; Akuza: “Vrasje me dashje”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elbana Lluri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me Paditës: {...}; E paditur: {...}; Objekti: “Zgjidhje martese, rregullimi pasojave”.

### **GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Iliba Bezati, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Dhunë në familje”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Skënder Damini, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me Të pandehur: {...}, {...}, etj.; Objekti: “Dërgim çështje në gjyq”.

### **GJYKATA E APELIT SHKODËR**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja (relator), Anita Mici dhe Valbon Çekrezi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me Paditës: {...}; E paditur: {...}; Objekti: “Kundërshtim vendimi”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Izet Dushaj (relator), Anita Mici dhe Valbon Çekrezi , caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Kthim Shume”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Izet Dushaj dhe Igerta Hysi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Njohje pronar.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 291 e 242/2 të Kodit Penal”

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi dhe Florjan Kalaja caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 283/2 i Kodit Penal”.

6. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja dhe Anita Mici, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 248 i Kodit Penal”.

7. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi dhe Izet Dushaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Shuarje dënimi”.

### **GJYKATA E APELIT VLORË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen civile me Paditëse: {...} I paditur: {...}; Objekti: “Detyrim njohje pronar”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; I pandehur: {...}; Viktima: {...}; Akuza: Dhuna në familje.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë; I pandehur: {...}; Akuza: “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**